EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5724
E mërkurë, 13 mars 2019
çmimi 0.40 €

Dogana rrit numrin e kontrolleve në tërë territorin e Kosovës

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", LIRAK ÇELAJ FAQE 4-5

TAKSA S'KA NDIKIM NË AGJENDËN EVROPIANE DHE LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Zëvendësministri i Integrimit Evropian, Lirak Çelaj, ka bërë me dije se agjenda evropiane e Kosovës është duke u realizuar pa pengesa. Ai ka thënë se deri më tani nuk ka pasur ndonjë ftohje apo shkëputje të raporteve në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Çelaj ka deklaruar se çështja e taksës ndaj produkteve serbe nuk ka reflektuar në ndonjërën prej proceseve të agjendës evropiane. Ai ka thënë se stopimi i procesit të liberalizimit të vizave është çështje politike nga ana e Bashkimit Evropian mirëpo, sipas Çelajt, nuk pritet të ketë ndonjë kriter shtesë. Ai ka theksuar se ka gjasa që vendimi për heqjen e vizave të merret pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian, përkatësisht në takimin e Këshillit të Ministrave të BE-së

SHPENZIMET E PAPARASHIKUARA PËRPLASIN PUSHTETIN DHE OPOZITËN

Me akuza ndërmjet deputetëve të partive në pushtet dhe atyre në opozitë, Kuvendi i Kosovës të martën ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme, në të cilën është diskutuar lidhur me ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara nga ana e Qeverisë. Deputetët e opozitës kanë thënë se Qeveria ka filluar zbatimin e një praktike të keqe për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara. Sa i përket çështjes së shpenzimeve të paparashikuara, kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se kjo praktikë ekziston që nga koha e qeverive paraprake

Haradinaj: Gjithë aleatët ndërkombëtarë po kërkojnë heqjen e taksës

FAQE 3

AKTUALE

HISTORIKU I PANOS ME FOTOGRAFINË E SKALITUR TË JASHARËVE

F. 8

Lulëzim ETEMAJ

BARNATORET NË QKUK DO TË MONITOROHEN NGA KAMERAT

F. 7

VAZHDOJNË HULUMTIMET DHE GËRMIMET PËR VARREZA MASIVE

F. 6

EKONOMI

ASETET E SISTEMIT FINANCIAR KANË SHËNUAR RRITJE VJETORE PREJ 6.9-PËRQINDËSH

F. 9

SHALA ME AMBASADORIN E KATARIT DISKUTOJNË PËR INVESTIMET NË KOSOVË

F. 9

KULTURË

NJË LIBËR I RËNDËSISHËM PËR DËSHMORIN ILIR DURMISHI

F. 13

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

SPORT

MKRS-ja U JEP MBI 750 MIJË EURO TRI FEDERATAVE

F. 13

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Cakaj: S'ka shtyrje, presim hapjen e negociatave me BE-në

TIRANË, 12 MARS - Megjithëse Shqipëria ka hyrë në një krizë politike, mazhoranca qeverisëse mendon se nga mbledhja e qershorit e Këshillit të Ministrave në Bruksel, do të kemi dritë jeshile për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE. Detajet se ku bazohet ky optimizëm i dha ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj. "Vendimi i këshillit thelbësor. Shqipëria ka përmbushur të gjitha detyrimet teknike për hapjen e negociatave. Reforma në drejtësi ka dhënë rezultatet më të larta të gjyqësorit. Shqipëria kontribut të çmuar në rajon. Shqipëria vepron në përputhshmëri të plotë me parimet dhe politikat e jashtme të BE-së. Shqipëria ka pasur mbështetjen absolute më tepër se të 25 vendeve anëtare për t'i hapur negociatat. Shqipëria sukses në 5 prioritetet kyçe. Vlera e takimeve të screening më shumë se teknike. Lufta kundër korrupsionit ka vazhduar të shënojë suksese të mëtejshme. Jemi besimplotë se rekomandimi i Komisionit për hapjen e negociatave do të jetë pozitiv", tha Cakaj. Gjatë takimit të Këshillit Kombëtar të Integrimit Cakaj, po ashtu, deklaroi se deri më tani nuk ka sinjale për një shtyrje vendimi përtej qershorit. "Mund të ketë shtyrje të raportit të Komisionit Evropian dhe kjo nuk ndikon në mbledhjen e qershorit", tha Cakaj.

Xhaçka: Kroacia ta mbështesë Kosovën në integrimet euroatlantike

Gjatë takimit me homologun kroat Damir Krstiçeviq, ministrja shqiptare e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, kërkoi nga Kroacia të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën e saj të integrimit euroatlantik, për të siguruar integrim të plotë, të të gjithë Ballkanit Perëndimor në NATO dhe në Bashkimin Evropian

ZAGREB, 12 MARS - Shqipëria dhe Kroacia do ta rrisin ndjeshëm bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë pas nënshkrimit të një memorandumi mirëkuptimi ndërmjet ministrit kroat të Mbrojtjes, Damir Krstiçeviq dhe ministres shqiptare Olta Xhaçka, gjatë vizitës së saj zyrtare në Zagreb, që përkon me 10-vjetorin e anëtarësimit të të dy vendeve në NATO. Në takimin mes zëvendëskryeministrit, njëherësh ministrit kroat të Mbrojtjes Krstiçeviq me ministren Xhaçka, u vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe në vite si dhe u diskutua për sfidat aktuale të sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

Dy ministrat ndanë të njëjtin mendim se anëtarësimi i Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO ka kontribuar më tej në qëndrueshmërinë e rajonit.

Ministri Krstiçeviq u shpreh i lumtur për nënshkrimin e memorandumit dhe shprehu mirënjohje për Shqipërinë që i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Kroacisë për një stërvitje të përbashkët në kuadër të 10-vjetorit të anëtarësimit në NATO. "Jam i kënaqur që nënshkruam sot një memorandum mirëkuptimi në fushën e mbrojtjes, i cili do të ofrojë stimul shtesë dhe do të sigurojë një bazë të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë. Falënderoj Shqipërinë, e cila konfirmoi pjesëmarrjen në stërvitjen ndërkombëtare ushtarake "Immediate Response 19", organizuar nga Kroacia me rastin e përvjetorit të anëtarësimit në NATO", tha ministri kroat.

Nga ana e saj, ministrja Xhaçka kërkoi nga Kroacia të vazhdojë të mbështesë Kosovën në rrugën e saj të integrimit euroatlantik, për të siguruar integrim të plotë, të të gjithë Ballkanit Perëndimor në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, ministrja Xhaçka vlerësoi rëndësinë e memorandumit, i cili nënshkruhet pas 16 vjetësh dhe që i përshtatet sfidave të kohës. "Mbas 16 vjetësh jam e bindur që ky memorandum do të sjellë një hov të ri të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve tona, sikundër jam e bindur që ky memorandum i ri mirëkuptimi, do të riorientojë edhe fokusin e ndërveprimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë ndërmjet vendeve tona, duke iu përshtatur sfidave të reja, nevojave specifike, angazhimit të përbashkët bilateral, por edhe bashkëpunimit rajonal dhe atë në NATO.

Jemi të sigurt që nga tani e tutje, bashkëpunimi ynë do të jetë edhe më cilësor, duke shërbyer si një element kyç në interes të sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në zonën Euroatlantike", u shpreh ministrja Xhaçka.

Pjesë e bisedës mes dy ministrave ishte edhe bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe arsimimit ushtarak, në kuadër të së cilës, ushtarakët shqiptarë do të mund të bëhen pjesë e Qendrës së Studimeve Detare Ushtarake në Split. Gjatë vizitës së saj në Kroaci, ministrja Xhaçka u takua edhe me kryetarin e Parlamentit Gordan Jandrokoviq dhe zëvendëskryeministren, njëherësh ministre e Jashtme dhe Çështjeve Evropiane, Marija Pejçinoviq Buriq.

Kryemadhi: Rama në 2017-n na u lut gjashtë muaj

TIRANË, 12 MARS - Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, gjatë një takimi me strukturat e partisë që ajo drejton në qytezën e Cërrikut, ka bërë deklarata shumë të forta, ku në epiqendër ka qenë kryeministri Edi Rama. "Jemi të tërë ish-deputetët që përfaqësojmë dëshirat dhe vendimet e qytetarëve. E themi këtë gjë sepse për herë të parë, deputetët e një Kuvendi morën një vendim që erdhi nga qytetarët. Protesta e 16 shkurtit na dha forcë dhe kurajë. Parlamenti ka ardhur si rezultati i votës së krimit. Ju e ndjeni përditë në çdo hallkë të shtetit. Ne ndjejmë edhe erën e kalbjes së shtetit. Duhet ndërtuar një sistem i ri", deklaroi kryetarja e LSI-së. Sipas Kryemadhit, në zgjedhjet e 2017-ës, Rama i është lutur LSI-së për rreth 6 muaj me radhë për të bërë koalicion me PS-në. "Pasuritë natyrore nuk i gëzojnë qytetarët shqiptarë. Ishim ne në pushtet me Edi Ramën, 6 muaj na u lut për të bërë koalicion me ne. por ne nuk pranuan sepse nuk mund të pranonim të mbulonim erën e keqe që kishte marrë qeveria. Po u bëre me qelbësirën, erë qelbësirë do të vish", u shpreh Kryemadhi.

Kryetarja e LSI-së shtoi se kreu i Qeverisë përdor buxhetin e shtetit për imazhin personal.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj: Gjithë aleatët ndërkombëtarë kërkojnë heqjen e taksës

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se edhe këshilltarët e kancelares gjermane, sikurse edhe aleatët e tjerë, i kanë kërkuar pezullimin e taksës ndaj mallrave serbe. Pas mbledhjes së Qeverisë, në një konferencë për media, Haradinaj ka thënë se, pavarësisht prej kërkesës së partnerëve perëndimorë, nuk mund ta heqë taksën pa i parë elementet përbërëse të marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 MARS - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka treguar të martën se të gjithë miqtë e Kosovës po kërkojnë pezullimin e taksës ndaj mallrave serbe. Në një konferencë për media, ai ka thënë se të njëjtën gjë ia kanë kërkuar edhe dy këshilltarët e lartë të kancerales gjermane, të cilën e kanë vizituar Kosovën një ditë më parë. "Pozicioni i Berlinit është i qartë, dialogu është i rëndësishëm dhe duhet të vazhdojë, taksa është pengesë dhe duhet ta hiqni. Ky është pozicioni i tij. Me respekt i kam dëgjuar. Kështu është pozicioni edhe i Londrës dhe i të tjerëve", ka thënë Haradinaj.

Pavarësisht prej këtyre kërkesave të partnerëve, ai ka thënë se nuk lëviz nga pozicioni i tij pa i parë elementet përbërëse të marrëveshjes finale ndërmjet dy vendeve. Madje Haradinaj ka vlerësuar se nuk është fer prej ndërkombëtarëve që po i bëjnë presion vetëm Kosovës për dialogun e cila ka qenë viktimë. "Nëse Serbia do të vë kushte për të mos ardhur në dialog, ne nuk mund ta kërcënojmë Serbinë, duke i thënë hajde në dialog. Bashkësia ndërkombëtare nuk po mund ta kërcënojë Serbinë, pra që t'i thotë kthehu në dialog, ndërkaq po i bënë presion viktimës, në këtë rast Kosovës që është më e vogël. Mendoj se këto nuk janë praktika të duhura. Jo që nuk duhet të ketë pasoja për Kosovën, por mendoj se duhet të kuptojnë të gjithë se është boll ta shkelësh viktimën. Në këtë rast, Kosova është viktima", është shprehur ai.

Kryeministri Haradinaj ka bërë me dije se duhet ta dijë çdokush se procesin e dialogut po e bllokon Serbia dhe jo Kosova. "Dialogun e ka bllokuar Beogradi, sepse ka thënë se pa u hequr taksa s'ka dialog. Pra, Kosova nuk e ka bllokuar dialogun. Kosova ka shkuar në dialog me të gjitha dhimbjet e veta. Me 20 mijë gra të dhunuara dhe mijëra të zhdukur. Neve na shqetëson kualiteti i kontratës. Imagjinojeni një kontratë të keqe e cila përgatitet diku dhe pastaj vjen në tavolinë, por atëherë është vonë dhe nuk mund t'i themi Amerikës dhe Evropës jo", ka thënë Haradinaj.

I pari i Qeverisë ka mohuar se po këmbëngul për taksën për të kërkuar garanci nga partnerët e Kosovës për marrëveshjen. Ai ka thënë se u beson amerikanëve dhe aleatëve të tjerë perëndimorë. "Nuk kam kërkuar garanci asnjëherë, por kam folur për kontratë. Në disa raste dikush qëndrimin tim e ka interpretuar si tip garancie por, jo. Unë nuk kam kërkuar garanci. I besoj Amerikës dhe aleatëve. Kur ata thonë diçka e di se është ashtu. Por, për shumë arsye, ne po kërkojmë një kontratë me elementet përbërëse të saj, përfshirë ekonominë dhe tregtinë e lirë. Kjo është ajo që po kërkojmë. Garanci më të madhe se njohja e Amerikës s'mund të kemi", është shprehur Haradinaj.

Kreu i Qeverisë ka treguar se, pavarësisht prej disa dallimeve që kanë krerët institucionalë, në një pikë kanë unitet të plotë. "Ne vërtet kemi pikëpamje të ndryshme në disa tema të caktuara, si unë, si presidenti, ashtu edhe kryeparlamentari. Por, ka diçka që është unik koalicioni qeverisës, përfshi këtu edhe një pjesë të opozitës. Ajo është platforma. Nuk mund të thuhet se Kosova nuk është duke folur me një zë. Ne jemi të gatshëm për dialog", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ai është shprehur i habitur me reagimet në Serbi për miratimin e platformës për bisedime në Kuvendin e Kosovës. Sipas tij, ky është dokument i Kosovës dhe për këtë nuk mund të pyetet Serbia.

Qeveria shqyrton platformën vjetore të politikës së inteligjencës dhe të sigurisë

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka shqyrtuar draftin e platformës vjetore të politikës së inteligjencës dhe të sigurisë. Në platformën vjetore të politikës së inteligjencës dhe sigurisë parashtrohen prioritetet strategjike të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, e cila, po ashtu, përmban udhëzimet e përgjithshme për punën e kësaj agjencie.

Në pajtim me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, drejtori i AKI-së propozon një version të platformës vjetore të politikës së inteligjencës dhe sigurisë për Këshillin e Sigurisë të Kosovës për shqyrtim nga ana e tyre. Pas konsultimit të kryeministrit me presidentin e Republikës së Kosovës, platforma i procedohet për miratim Qeverisë, ndërsa pas miratimit nga ana e Qeverisë, platforma i dërgohet Organit Mbikëqyrës Parlamentar për informim dhe drejtorit të AKI-së për veprim. Pas shqyrtimit nga kabineti qeveritar është miratuar nisma e Ministrisë së Financave për negocim të Marrëveshjes së kredisë me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Trajtimi i ujërave të zeza në Komunën e Gjilanit". Po në këtë mbledhje Qeveria ka ndarë mjete financiare, sipas kërkesës së Komunës së Mitrovicës, në vlerë prej 74 200 eurosh, për mbështetje të realizimit të projektit për ngritjen e monumentit kushtuar dëshmorit Harun Beka.

Komuna e Rahovecit dhe 'Caritas Kosova' nënshkruajnë kontratë për punësimin e 53 punëtorëve shëndetësorë

RAHOVEC, 12 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi dhe Don Viktor Sopi, drejtor gjeneral i "Caritas Kosova", në prani të Samir Mustafës, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kanë nënshkruar të martën kontratën "Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit shtretërit shtëpiak", me vlerë prej 194 398 eurosh.

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, kryetari Latifi ka thënë se sot e nënshkruan një kontratë të rëndësishme me "Caritas Kosovën" përmes së cilës do të punësohen 53 punëtorë shëndetësorë. "Me këtë synojmë ta rrisim edhe më tutje shërbimet shëndetësore në nivel komune", ka thënë ai.

Ndërsa Don Viktor Sopi, drejtor gjeneral i "Caritas Kosova", ka shtuar se ky projekt do të ndihmojë edhe punësimin e të papunëve dhe personat që janë pa përkujdesje dhe të palëvizshëm.

Flet për "Epokën e re", Lirak Çelaj

Taksa s'ka ndikim në agjendën ev

Zëvendësministri i Integrimit Evropian, Lirak Çelaj, ka bërë me dije se agjenda evropiane e Kosovës është duke u realizuar pa pengesa. Ai ka thënë se deri më tani nuk ka pasur ndonjë ftohje apo shkëputje të raporteve në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Çelaj ka deklaruar se çështja e taksës ndaj produkteve serbe nuk ka reflektuar në ndonjërën prej proceseve të agjendës evropiane. Ai ka thënë se stopimi i procesit të liberalizimit të vizave është çështje politike nga ana e Bashkimit Evropian mirëpo, sipas Çelajt, nuk pritet të ketë ndonjë kriter shtesë. Ai ka theksuar se ka gjasa që vendimi për heqjen e vizave të merret pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian, përkatësisht në takimin e Këshillit të Ministrave të BE-së

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 MARS - Zëvendësministri i Integrimit Evropian, Lirak Çelaj, ka thënë të martën se stopimi i procesit të liberalizimit të vizave është çështje e Bashkimit Evropian dhe nuk pritet që të ketë ndonjë kriter shtesë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se ekzistojnë gjasat që vendimi për heqjen e vizave të merret në qershor në takimin e Këshillit të Ministrave të BE-së. "Gjasat ekzistojnë, por meqë ky vendim nuk varet prej nesh, nuk jemi në pozicion që të garantojmë për këtë punë. Për vendimin për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës duhet të japin përgjigje institucionet relevante të BE-së. Është e vërtetë se në vazhdimësi na është thënë se procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën ndërlidhet me zgjedhjet në Parlamentin Evropian. Po ashtu, na është thënë tekstualisht se kriteret janë plotësuar nga ana e Kosovës, por Evropa ka disa probleme dhe liberalizimi mbase mund të mbetet në plan të dytë", është shprehur Çelaj, duke shtuar se çështja e taksës nuk ka reflektuar në këtë proces dhe në asnjërën prej proceseve të agjendës evropiane. "Deri më sot nuk është diskutuar për taksën në këtë aspekt. Nuk e di se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, mirëpo deri më tani nuk na është thënë se do të ndikojë. Kështu që, nuk kam dëgjuar ndonjë zyrtar të BE-së që të ketë thënë se kjo çështje mund të ndikojë në liberalizimin e vizave. Prandaj çështja e taksës nuk do të duhej të ndikonte", ka theksuar ai.

Çelaj ka bërë me dije se agjenda evropiane e Kosovës është duke u realizuar pa pengesa. Në këtë kontekst, ai ka deklaruar se deri më tani nuk ka pasur ndonjë ftohje apo shkëputje të raporteve në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. "Komunikimi është duke vazhduar dhe ne si qeveri po përpiqemi t'i plotësojmë të gjitha kriteret që çojnë deri tek anëtarësimi i Kosovës në BE. Kurse kjo çështja e taksës më shumë ndërlidhet me procesin e dialogut Kosovë - Serbi dhe nuk ka reflektuar në ndonjërën prej proceseve të agjendës evropiane", ka thënë ai.

"Epoka e re": *Z. Çelaj, çfarë është duke ndodhur me procesin e liberalizimit të vizave dhe ju si Ministri e Integrimit Evropian, çfarë jeni duke bërë në këtë drejtim?*

Çelaj: Ministria e Integrimit Evropian në këtë proces ka pasur më shumë rol koordinues, kurse përgjegjësitë për shumicën e obligimeve i kanë pasur ministritë dhe institucionet e tjera. Në vazhdimësi po bëjmë monitorimin e institucioneve për procesin integrues në përgjithësi, kurse sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, Qeveria e Kosovës ka kohë që i ka plotësuar të gjitha kriteret që janë kërkuar për ta fituar të drejtën e lëvizjes pa viza. Stopimi i këtij procesi është çështje politike nga ana e

ropiane dhe liberalizimin e vizave

Bashkimit Evropian dhe nuk pritet të ketë ndonjë kriter shtesë.

"Epoka e re": *Sa ka gjasa reale që pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian që do të mbahen në qershor të merret vendimi për heqjen e vizave?*
Çelaj: Gjasat ekzistojnë, por meqë ky vendim nuk varet prej nesh, nuk jemi në pozicionin të garantojmë për këtë punë. Për vendimin për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës duhet të japin përgjigje institucionet relevante të BE-së. Mirëpo është e vërtetë se në vazhdimësi na është thënë se procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën ndërlidhet me zgjedhjet në Parlamentin Evropian. Po ashtu, na është thënë tekstualisht se kriteret janë plotësuar nga ana e Kosovës, por Evropa ka disa probleme dhe liberalizimi mbase mund të mbetet në plan të dytë.

"Epoka e re": *Duke i pasur parasysh problemet me të cilat ballafaqohet aktualisht BE-ja, ka rrezik që as në qershor mos të ketë vendimmarrje për Kosovën?*
Çelaj: Rreziku ekziston sepse pritjet tona kanë qenë që ky proces të përfundojë shumë më herët, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Çdo premtim me data nga ana jonë do të ishte gabim. Prandaj në këtë drejtim nuk mund të them asgjë më shumë.

"Epoka e re": *Keni paraparë ndonjë strategji apo plan konkret se si do t'i qasen këtij procesi deri në finalizimin e tij, sidomos sa iu përket vendeve që kanë pasur hezitim për heqjen e vizave?*
Çelaj: Ka pasur një varg takimesh të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës me përfaqësuesit e shteteve të cilat mund të kenë ndikim në aprovimin apo mosaprovimin e këtij vendimi. Natyrisht se lobimi për liberalizim të vizave do të vazhdojë edhe më tutje me të njëjtin ritëm.

"Epoka e re": *Në muajt e fundit është folur shumë për pasojat që do t'i ketë Kosova nëse nuk do ta pezullojë taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Kjo çështje mund të paraqesë pengesa edhe në procesin e liberalizimit të vizave?*
Çelaj: Deri më sot nuk është diskutuar për taksën në këtë aspekt. Nuk e di se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, mirëpo deri më tani nuk na është thënë se do të ndikojë. Procesi i liberalizimit të vizave është teknik dhe Kosova i ka plotësuar kushtet teknike. Po ashtu, jam i vetëdijshëm se ky është edhe proces politik dhe për këtë arsye nuk është aprovuar vendimi në kohën kur është dashur. Kështu që, nuk kam dëgjuar ndonjë zyrtar të BE-së që të ketë thënë se kjo çështje mund të ndikojë në liberalizimin e vizave. Prandaj çështja e taksës nuk do të duhej të ndikonte.

"Epoka e re": *Mund të ketë ndikim në agjendën evropiane të Kosovës?*
Çelaj: Agjendën evropiane të Republikës së Kosovës jemi duke e vazhduar pa pengesa. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë ftohje ose ndonjë shkëputje të raporteve në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Komunikimi është duke vazhduar dhe si qeveri në përgjithësi po përpiqemi t'i plotësojmë të gjitha kriteret që çojnë deri tek anëtarësimi i Kosovës në BE. Kurse kjo çështja e taksës më shumë ndërlidhet me procesin e dialogut Kosovë - Serbi dhe nuk ka reflektuar në ndonjërën prej proceseve të agjendës evropiane.

"Epoka e re": *Në këto raporte nuk ka ndikuar mosdëgjueshmëria e Kosovës për heqjen e taksës pas thirrjeve të vazhdueshme të BE-së.*
Çelaj: Procesi i integrimeve evropiane që përfshin shumë fusha po vazhdon pa u ndikuar nga taksa dhe deklarimet rreth saj. Kurse sa i përket liberalizimit të vizave, ka pasur kritika nga të gjithë ne sepse ka qenë një vendim i padrejtë që qytetarët e Kosovës ende nuk e gëzojnë të drejtën për lëvizjen e lirë. Këtu nuk ka asnjë dilemë dhe këtë e kemi thënë zëshëm.

"Epoka e re": *Pas këtyre zhvillimeve Kosova mund të mos përfitojë fonde nga BE-ja?*
Çelaj: Deri më tani nuk është humbur asnjë cent nga fondet e BE-së. Natyrisht se çdo projekt që nuk realizohet me kohë edhe rrezikon të humbet, por shpresojmë se nuk do të ndodhë një gjë e tillë. Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka rritur angazhimin në raport me institucionet të cilat janë përfituese të fondit IPA për t'i zbatuar ato me kohë. Presim nga institucionet e përfshira në këtë proces të jenë të përgjegjshme dhe t'i realizojnë me kohë. Përgjegjëse për këtë janë institucionet përfituese sepse nuk është në dorën e Ministrisë së Integrimit Evropian t'i zbatojë apo mos t'i zbatojë.

"Epoka e re": *Z. Çelaj, cila është dinamika e procesit të zbatimit të MSA-së?*
Çelaj: Është një trend pozitiv dhe besoj se jemi në rrugën e duhur. Pra, ka rritje të zbatimit të masave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Natyrisht se ka edhe shumë sfida me të cilat duhet të merremi, mirëpo trendi është pozitiv dhe ky trend duhet të vazhdojë.

Projektet lokale të Kaçanikut dhe Ferizajt marrin mbështetjen e Ministrisë së Infrastrukturës

Prishtinë, 12 mars (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të martën ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me krerët e Kaçanikut dhe të Ferizajt. Këto marrëveshje bashkëpunimi u nënshkruan në frymën e mbështetjes së projekteve lokale nga MIT, që kanë për synim financimin e projekteve lokale që shkojnë përtej mundësive buxhetore të komunave.
Për Komunën e Kaçanikut, MIT për vitin 2019 ka ndarë shumën prej 705 000 eurosh për realizimin e pesë projekteve, kurse Ferizaj nga MIT përfiton shumën prej 300 000 eurosh për realizimin e projekteve të reja për këtë komunë. Për të gjitha projektet e mbështetura për këtë vit janë bërë planifikimet buxhetore edhe për vitet në vijim, deri në përfundimin e plotë të tyre.
Ministri Lekaj, duke i siguruar kryetarët e Kaçanikut dhe të Ferizajt se mbështetja e dikasterit që ai drejton nuk do të mungojë asnjëherë, ka kërkuar nga ta që të jenë zbatues të mirë të projekteve që po financohen nga MIT sepse bëhet fjalë për interesin e qytetarëve dhe ky duhet të mbetet prioritet i të dy niveleve të qeverisjes.
Dy kryetarët e komunave nënshkruese të marrëveshjeve të bashkëpunimit e falënderuan ministrin për përkrahje dhe u zotuan se realizimi i të gjitha projekteve në komunat e tyre do të bëhet konform standardeve të kërkuara dhe në harmoni me afatet e përcaktuara për përfundimin e tyre.

Vazhdojnë hulumtimet dhe gërmimet për varreza masive

PRISHTINË, 12 MARS - Gjatë këtij viti nga Serbia ende nuk ka pasur asnjë rast të identifikimit dhe riatdhesimit të mbetjeve mortore të personave të pagjetur të Kosovës, por puna dhe komunikimi ndërmjet delegacioneve shtetërore për çështjen e personave të pagjetur të të dyja vendeve është duke vazhduar, konfirmojnë zyrtarët e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur të Kosovës.

Më 6 tetor të vitit 2018 delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë për personat e pagjetur kanë arritur pajtimin, i cili i obligon të dyja vendet për lehtësimin e procedurave të riatdhesimit të mbetjeve mortore të personave të identifikuar, të cilët më parë ishin të pagjetur.

Kushtrim Gara, udhëheqës njësi në kuadër të Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se me përmirësimin e kushteve klimatike pritet që puna në terren për hulumtimin e varrezave të mundshme masive të shtohet. "Punë ka në vazhdimësi. Në këtë rast edhe komunikimi ndërmjet palëve është i vazhdueshëm ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe delegacionit të Serbisë. Ne tash, me përmirësimin e kushteve të motit, kemi vazhduar ose kemi nisur edhe punën në terren. Puna në terren, në këtë rast, gërmimet vlerësuese dhe zhvarrimet e mbetjeve mortore që realizohen, pastaj ka një procedurë të nevojshme mjeko-ligjore në përpjekje për t'i identifikuar mbetjet mortore që zhvarrosen. Në qoftë se mbetjet mortore, pastaj mund të ndërlidhen me rastet që janë në interes edhe të palës tjetër, atëherë sigurisht se do të vazhdohet komunikimi për respektim të procedurave të marrëveshjes që i referohemi, por edhe marrëveshjeve paraprake", ka thënë Gara.

Ai ka shtuar se tashmë është java e dytë që pala e Kosovës po i zhvillon punimet në terren, brenda territorit të vendit dhe tashmë gërmimet që janë zhvilluar kanë dhënë rezultate. "Kjo javë është dyta e fillimit të punimeve në terren. Këtë javë janë planifikuar të hapen tre lokacione (për gërmime). Javën e kaluar i kemi pasur dy lokacione në të cilat tashmë është punuar dhe nga këto dy lokacione ka pasur edhe gjetje dhe zhvarrosje të mbetjeve mortore. Por, do të jemi të kujdesshëm, në kuptimin e interpretimit të numrave të mbetjeve mortore apo individëve që janë zhvarrosur, sepse në këtë rast janë duke u zhvilluar procedurat e nevojshme mjekoligjore dhe të identifikimit përmes analizës së ADN-së, që do ta përcaktojë numrin e mbetjeve mortore apo individëve të zhvarrosur, pastaj edhe përkatësinë etnike, gjinore dhe të tjera, që janë të nevojshme", ka thënë Gara. Sipas tij, deri më tash janë rreth 10 lokacione të dyshuara si varreza të mundshme, për të cilat është siguruar urdhëresa e nevojshme nga Prokuroria Speciale e Kosovës për fillimin e hulumtimit dhe gërmimit në ato lokacione.

Ndërkaq Ahmet Grajçevci, kryetar i Këshillit Koordinues të Familjarëve të Personave të Pagjetur në Kosovë, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka theksuar se gjatë dy vjetëve të fundit Qeveria e Kosovës ka bërë punë më dinamike lidhur me çështjen e personave të pagjetur. "Familjarët në dy vjetët e fundit kanë bashkëpunim më të mirë sesa në vitet e kaluara me institucionet e Kosovës, sepse qeveria e tanishme ka marrë hapa më të mëdhenj për punë rreth këtij procesi. Kështu që, shpresoj se me një trysni të bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve të Kosovës, mbi Qeverinë e Beogradit, do të kishim rezultate më të mira dhe do të vinte deri te zbulimi dhe identifikimi i varrezave masive në Serbi", ka thënë Grajçevci.

Zyrtarët e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur kanë theksuar se gjatë kësaj jave do të mbahet një takim i delegacioneve nga vendet e rajonit, që janë kompetente për personat e pagjetur, për të biseduar për çështjen e mbetjeve mortore të gjetura, por të paidentifikuara. Aktualisht ende mbetet i pazbardhur fati i mbi 1 600 personave të pagjetur që nga lufta në Kosovë, e viteve 1998 dhe 1999.

Lansohet programi 'Shkollat e shekullit 21'

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, bashkë me ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruari O'Connell dhe drejtorin e Edukimit për Evropën në British Council, Richard Everitt, kanë marrë pjesë në lansimin e Programit për 'Shkollat e shekullit 21' në Ballkanin Perëndimor, i cili ka për qëllim rritjen e perspektivës për punësimin dhe përmirësimin e praktikave në klasë. Me këtë rast, janë zhvilluar disa aktivitete ku ministri Bytyqi bashkë me ambasadorin O'Connell kanë marrë pjesë.

Ata fillimisht kanë qëndruar në vendin ku kanë prezantuar klubet koduese, e më pas kanë takuar ekipet dhe mësimdhënësit e tyre, ku është dhënë rasti për të mësuar më shumë për projektet dhe përvojën e tyre me microbit, ndërsa kanë dëgjuar edhe prezantimin e shkollave pjesëmarrëse në fazën pilot të Programit gjatë vitit 2018.

Në fillim të ceremonisë së hapjes së këtij Programi, fillimisht ka përcjellë urimet e tij ministri për Evropë Sir. Alan Duncan. Ndërsa ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruari O'Connell, ndër të tjera, theksoi se ky është programi më i madh i Britanisë në arsimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Ministri Bytyqi me këtë rast ka theksuar se ky është një projekt me rëndësi të madhe për sistemin arsimor dhe falënderoi Britaninë e Madhe për këtë mundësi që po ua jep nxënësve tanë. "Ne themi me mburrje se në Kosovë e kemi një pasuri të madhe dhe kjo është rinia jonë. Por, kësaj rinie ne duhet t'i ofrojmë mundësi që ta pajisim me shkathtësi të nevojshme dhe konsideroj se shkathtësitë që po iu ofrohen me këtë projekt janë mundësia më e mirë që të rinjtë tanë të përgatiten jo vetëm për të ardhmen e tyre, por edhe për të ardhmen e vendit tonë", ka thënë Bytyqi.

Ministri Bytyqi ka pohuar se MAShT-i është shumë e angazhuar në këtë projekt bashkë me British Council, në mënyrë që projekti të jetë i suksesshëm përgjatë tri vjetëve që do të zbatohet në shkollat e Kosovës. Ai ka bërë me dije se bashkë me ekspertët po shqyrtohet mundësia që kjo pjesë të futet edhe në kurrikulë të klasës së tetë, pra të jetë një projekt i vazhdueshëm që do t'ua ofrojë këtë mundësi nxënësve për përgatitjen e tyre.

Programi 'Shkollat e shekullit 21' është program edukativ, në vlerë prej 10 milionë funteve, i cili është dizajnuar nga British Council dhe është financuar nga Qeveria e Britanisë. Programi mbi një milion nxënësve të moshës 10-15 vjet nga Ballkani Perëndimor do t'u ofrojë shkathtësi në mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe kodim.

Reçica takon përfaqësues të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur në takim të martën përfaqësues të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, nga të cilët u informua rreth procesit sa i përket koncept-dokumentit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Persona të Zhdukur. Në takim u diskutua me theks rreth çështjes së pensioneve të dyfishta.

Ministri Reçica i njoftoi përfaqësuesit e Komisionit se në koncept-dokumentin për reformë pensionale të hartuar nga MPMS-ja, i cili është miratuar në Qeveri, është paraparë edhe trajtimi i pensioneve të dyfishta. "Ky koncept-dokument i përshtatet më së miri situatës socio-ekonomike të vendit dhe synon trajtimin meritor të të gjitha kategorive, andaj është e rëndësishme që ky koncept të merret parasysh nga komisioni i krijuar në Kuvend, i ngarkuar për të hartuar Kodin e Pensioneve, si dhe të konsultohet edhe nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur gjatë plotësim-ndryshimit të Ligjit për persona të zhdukur", ka thënë ministri Reçica.

Dogana rrit numrin e kontrolleve në tërë territorin e Kosovës

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Në vazhdën e aktiviteteve për luftimin e kontrabandës, gjatë javës së kaluar zyrtarët doganorë kanë ndërmarrë një mori aktivitetesh në të gjithë territorin e Kosovës. Dogana ka rritur numrin e kontrolleve fizike ndaj automjeteve, mallrave dhe personave. Gjatë kësaj kohe janë ushtruar 507 aktivitete në tërësi duke filluar nga kontrollimet si dhe deri te patrullimet. Rritja e kontrolleve dhe patrullimeve ka rezultuar me 18 kundërvajtje si të personave fizikë, po ashtu edhe të subjekteve juridike. Këto aktivitete kanë rezultuar me zbulimin e 18 rasteve të mallrave të dyshimta kontrabandë, kryesisht pije alkoolike dhe joalkoolike, ushqime të gatshme dhe teknikë të ndryshme, vlera e të cilave është 25 000 euro. Gjithashtu, siç e parashohin dispozitat relevante ligjore, është aplikuar masa e sekuestrimit të automjeteve transportuese në sasi prej dy copë.

Zbulohet një lloj i kërmillit në Kosovë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 MARS - Në kuadër të procesit për hartimin e Librit të Kuq të Faunës së Kosovës, që po realizohet në kuadër të Programit Mjedisor për Kosovën KEP2016, në mesin e shumë llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës, është zbuluar edhe një lloj i kërmillit që për herë të parë përmendet në listën e llojeve shtazore të Kosovës. "Lloji i kërmillit Vertigo moulinsiana është gjetur në zonat e përmbytura të lumit Lepec në fshatin Drekovc të Ferizajt, në një ekosistem të livadheve me lagështi, i rrethuar me toka të punës dhe pyje të plepit", është bërë me dije në njoftimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.
Bëhet me dije se lloji i kërmillit Vertigo moulinsiana për herë të parë është përshkruar nga Dupuy në vitin 1849. Ai është një lloj indikatori i zonave të Natura 2000 dhe, sipas burimeve të deritanishme nga hulumtimet e realizuara në Kosovë, nuk ka qenë i identifikuar më herët në vendin tonë.
Sa i përket shkallës së rrezikshmërisë në nivel evropian, sipas kategorizimit nga Unioni Ndërkombëtar i Konservimit të Natyrës (IUCN), lloji është vlerësuar se i takon kategorisë "I përkeqësuar" (Vulnerable A2ac). "Lloji është identifikuar gjatë hulumtimeve të realizuara në Kosovë nga ekspertët hungarez ë Zoltan Feher, Tamas Deli dhe Zoltan Peter Eross, në bashkëpunim me ekspertin nga Kosova Halil Ibrahimi nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit të Prishtinës si pjesë e hulumtimeve për hartimin e Librit të Kuq të Faunës së Kosovës që po realizohet nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të komponentës së dytë të Programit Mjedisor për Kosovën KEP2016", është theksuar në njoftimin e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.



Instituti i Shëndetësisë diskuton për ndryshimin e ligjit për sëmundjet ngjitëse

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës të martën është mbajtur një takim për të diskutuar për nevojën e ndryshimit të Ligjit për sëmundje ngjitëse në Kosovë.
Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve shëndetësore, Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve etj., është bërë prezantimi i aspekteve kryesore që e arsyetojnë nevojën për ndryshimin e këtij ligji, zbrazëtirat dhe vështirësitë që i ka pasur në zbatim ligji aktual, si dhe efektet e drejtpërdrejta.
Në takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Kosovës të cilët janë duke i dhënë asistencë profesionale grupit punues për hartimin e këtij konceptdokumenti.
Në proces të hartimit të këtij konceptdokumenti grupi punues do ta zhvillojë edhe më tej dokumentin, duke mbajtur në vijim edhe konsultime publike me palët e interesuara dhe palët të cilat ndikohen nga një dokument i tillë.

Barnatoret në QKUK do të monitorohen nga kamerat

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se Qendra Klinike dhe Universitare e Kosovës (QKUK) do të bëhet me 90 barnatore të cilat do të funksionojnë në kuadër të reparteve të kësaj klinike. Ismaili ka thënë se këto barnatore do të monitorohen nga kamerat. "Për 20 vjet nuk ka pasur asnjëherë asnjë sistem të mirëfilltë se si janë menaxhuar barnat në QKUK. Barnat që janë blerë jo gjithherë kanë arritur deri te pacienti. Për më tepër, këto janë 'barnatoret' e vjetra në të cilat janë mbajtur ilaçet, pa asnjë siguri dhe asnjë kriter për ruajtjen e tyre. Prandaj është nisur 'Transformimi farmaceutik', që përmban 14 barnatore klinike dhe rreth 90 barnatore të reparteve. Çdo barnatore do të jetë e monitoruar me sistem elektronik, kamera, barkode dhe dyer me qasje të kufizuar. Çdo ilaç i blerë do të shkojë deri te pacienti", ka thënë të martën ministri Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook", duke postuar edhe disa fotografi të rregullimit të këtyre barnatoreve.

HISTORIKU I PANOS ME FOTOGRAFINË E SKALITUR TË JASHARËVE

Lulëzim ETEMAJ

Shkrimin tim të fundit, "Zëri i Kosovës, 'Bota e re' dhe fotografia e Jasharëve", rreth historikut të fotografisë së Shaban, Hamëz dhe Adem Jasharit, me emblemën e UÇK-së në prapavijë, të publikuar për herë të parë në këto dy gazeta mbështetëse kryesore të luftës së UÇK-së, e kam konsideruar të papërfunduar për faktin se mungonte edhe historiku i panos së mermerit, e vendosur në hyrje të kullave të Jasharëve, me po këtë fotografi të skalitur të heronjve. Në fakt, ky historik është një historik tërësisht më vete. Fillesën e tij e shënon koha e pasçlirimit të Kosovës, përkatësisht viti 2000. Përderisa, siç kam shkruar më herët, fotografia e heronjve ishte punuar (në dhjetor 1998 dhe mars 1999) nga kryeredaktori i "Zërit të Kosovës", preshevari Adnan Asllani, tani ideja e gdhendjes së të njëjtës fotografi në pllakë mermeri dhe vendosjes si pano tek kullat e Jasharëve, vjen nga artisti i telentuar për gdhendjen e fotografive në mermer, tetovari Bajramali Idrizi, me qëndrim në Danimarkë. Ideja e Bajramali Idrizi, i cili me mjeshtri të rrallë, përkushtim e dashuri të madhe i gdhend me gjilpërë diamanti në pllakën e zezë të granitit figurat e heronjve tanë kombëtarë Shaban, Adem dhe Hamëz Jashari, vepra monumentale është gati për t'u përcjellë në Prekazin heroik. Pllaka peshon 255 kg, ndërsa ka kushtuar 3000 marka të kohës së atëhershme. E gjitha ndodhë një vit pas çlirimit të Kosovës, gjatë muajve korrik-gusht të vitit 2000.

Sfida kryesore: transportimi i veprës artistike në Kosovë. Destinacion është Maqedonia, ndërsa dërgimi bëhet përmes shërbimit logjistik ndërkombëtar, të njohur si "DHL", i themeluar në vitin 1969 në San Francisko nga Adrin Dalsey, Larry Hillblom dhe Robert Lynn, i cili aktualisht ka mbi 510 000 të punësuar në mbi 220 vende të botës. Me të arritur në Maqedoni, dërgesa kthehet prapa nga maqedonasit. Ky kthim prapa nuk e dekurajon grupin që merrej me dërgimin e pllakës së mermerit në Kosovë. Përkundrazi, pasi e gjithë pllaka ngjyroset me ngjyrë të bardhë nga artisti Idrizi, për t'ia mbuluar përmbajtjen, ajo dërgohet sërish përmes "DHL"-it në Maqedoni. Pas ndalimit nëntëditësh që i bëhet nga maqedonasit, falë përkushtimit të Xhemil Idrizit dhe Avzilatif Xhemailit, të cilët i dhanë mito një maqedonasi shumën prej 950 markash, pllaka mund të tërhiqet nga dogana maqedonase. Paraprakisht, Xhemil Idrizi merr pushim nga puna në Danimarkë për të shkuar enkas në Maqedoni, që të merrej me tërheqjen e saj.

Avzilatif Xhemaili është gjithashtu tetovar. Tani ai është një nga afaristët më të suksesshëm në Tetovë dhe Prishtinë. Gjatë kohës së luftës në Kosovë ka dhënë kontribut të posaçëm duke e furnizuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me barna, madje edhe duke paguar njerëz, shqiptarë të Kosovës, për t'i dërguar barnat në mal për mjekimin e plagëve të ushtarëve të lirisë.

Kalimi i doganës së Maqedonisë, nuk paraqet kalimin e të gjitha pengesave të kthimit të Jasharëve të skalitur tani në mermer në shtëpinë e tyre, në Prekaz të Drenicës. Kufiri i Kosovës, kjo është pika tjetër e zhvendosjes së sfidës. Pengesa e hyrjes e ka një arsyetim krejt banal: "Punimi është sjell për shitje, prandaj nuk mund të hyjë në Kosovë". Por Xhemil Idrizi dhe Avzilatif Xhemaili, të cilët po merreshin personalisht me organizimin e transportimit për në Kosovë, nuk janë nga ata që ndalen lehtë në realizimin e qëllimit të tyre. Biseda telefonike e Avzilatif Xhemailit me një mik të tij në Kosovë bën që t'u hapet kufiri dhe lejohet hyrja. Këtu përfundon edhe detyra e maqedonasit, që ishte paguar për nxjerrjen e pllakës nga dogana dhe duart e policisë maqedonase dhe sjelljen e saj deri në kufi.

Idrizit e gjen përkrahjen unanime të miqve të tij, anëtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), si dhe strukturave drejtuese të Fondit të UÇK-së "Vendlindja Thërret": Musa Krasniqi, kryetar i fondit dhe simpatizant i LPK-së, Xhemil Idrizi, i vëllai i Bajramali Idrizit, nënkryetar i fondit, Ibrahim Xhemajli, sekretar i fondit, njëherësh edhe anëtar i strukturave kryesore drejtuese të LPK-së në Danimarkë, si dhe Abdylbaki Ademi, arkatar i fondit.

Pas mbi 500 orë punë të bëra nga artisti i talentuar autodidakt, Vepra monumentale e Bajramali Idrizit transportohet nga Ferizaj, vendlindja e Ibrahim Xhemajlit, në Prekaz me një mjet të kryetarit të "Feniksit", Milaim Jashari, ish i burgosur politik, me të cilin Xhemalji kishte qëndruar në burgun e Pozharevcit.

Pas bisedës telefonike, që e zhvillon me të Ibrahim Xhemajli, cicëroni në atë kohë i kompleksit, Rifat Bejta, tregon mirëkuptim dhe shpreh përkrahjen e tij për vendosjen e pllakës në hyrje të kullave të Jasharëve, ku ndodhet që nga ajo ditë. Paraprakisht pllakës i është hequr ngjyra me të cilën ishte ngjyrosur për të mbuluar përmbajtjen e saj për shkaqet që është shkruar më lartë.

Duke qenë se në fillim portretet e heronjve Shaban, Adem dhe Hamëz Jashari, të gdhendur në pllakën e mermerit, ishin vetëm bardhë e zi dhe jo me ngjyra, siç ishin në fotografinë origjinale të botuar nga gazeta "Zëri i Kosovës" në prag të njëvjetorit të rënies së tyre heroike, artisti Bajramali Idrizi nuk e konsideronte veprën e tij ende të përfunduar. Një vit më vonë, shkon sërish në Prekaz. Kësaj here për t'u dhënë figurave ngjyrën e tyre të natyrshme. Atë e shoqërojnë Ibrahim Xhemajli dhe Avzilatif Xhemaili. Ndërsa për pastrimin e nevojshëm të pllakës së mermerit nevojitej një lëng kimik i posaçëm, i cili sipas udhëzimeve mund të blihej në ndonjë punëtori që merrej me ngjyrosjen e automjeteve.

Grotesku që i paraprinë ngjyrosjes së figurave të heronjve: Shkon Ibrahim Xhemajli në Skenderaj dhe hynë në një punëtori për të blerë lëngun për pastrimin e pllakës së mermerit. Meqë bie në sy si i "huaj", pyetet se prej nga është dhe përse kishte ardhur. Pasi Xhemajli e tregon qëllimin e qëndrimit në Skenderaj dhe çfarë kërkonte në këtë punëtori, punëtori i saj i thotë ta ketë pasur shok Adem Jasharin. Në fund, Xhemajli, i cili kishte udhëtuar enkas nga Danimarka për t'u marrë me vendosjen e panos, duke bartur vetë të gjitha shpenzimet e udhëtimit, e kërkon faturën për ta bërë pagesën. Paguan pesë markat që i kërkohen dhe, duke qenë i indinjuar me këtë qëndrim të "shokut" të Adem Jasharit, i drejtohet me këto fjalë: "Mirë e kuptova se sa shok e paskeni pasur Adem Jasharin, kur nuk jeni në gjendje pesë marka t'i sakrifikoni, kurse ne, dy persona, kemi ardhur nga Danimarka, duke e lënë punën dhe duke paguar shpenzimet vetë, pa menduar fare se po shpenzohemi". Punëtori e mbyll gojën dhe e ul kokën i turpëruar.

Pas rreth 2-3 ditësh punë, Bajramali Idrizi i bën Jasharët e skalitur prej tij mjeshtërisht në pllakën e mermerit të flasin përmes ngjyrave të shumta. Përjetësimi artistik i Adem, Shaban dhe Hamëz Jasharit, nga panoja e vendosur në hyrje të kullave, shpërfaq heroizmin e tyre dhe të familjes, nga më të rrallët në të gjithë historinë e njerëzimit. Iu tregon vizitorëve të shumtë, se kush ishin pronarët dhe dalzotësit e atyre kullave, dalzotësit dhe kthyesit e dinjitetit të Kosovës dhe shqiptarëve, flijimi i të cilëve ia hapi rrugën pakthyeshëm çlirimit, lirisë dhe pavarësimit të Kosovës.

Shala me ambasadorin e Katarit diskutojnë për investimet në Kosovë

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Katarit në Tiranë, jorezident në Republikën e Kosovë, Ali Bin Hamad Al Marri, me të cilin ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit dhe për nisjen e një kapitulli të ri ekonomik në mes të Kosovës dhe Katarit.

Në profilin e vet në "Facebook", Shala ka shkruar se diplomatin nga Katari e ka njoftuar me kushtet që i ofron Kosova në fushën e investimeve të huaja. "Ishte kënaqësi ta prisja sot në zyrën time ambasadorin e Katarit në Tiranë, jorezident në Republikën e Kosovës, Ali Bin Hamad Al Marri. Me ambasadorin diskutuam për thellimin e bashkëpunimit dhe për nisjen e një kapitulli të ri ekonomik në mes të Kosovës dhe Katarit. Ambasadori ishte i impresionuar me zhvillimin e Kosovës, duke theksuar se shteti i tij do të vazhdojë ta mbështesë Republikën e Kosovës. Al Marrin e njoftova me kushtet që i ofron Kosova në fushën e investimeve të huaja dhe ia shpjegova Ligjin për Investime Strategjike, duke e garantuar se çdo investitor potencial që synon të investojë në Kosovë do të trajtohet me këtë ligj që ofron lehtësira të jashtëzakonshme", ka shkruar Shala.

Shpenzimet e paparashikuara përplasin pushtetin dhe opozitën

Me akuza ndërmjet deputetëve të partive në pushtet dhe atyre në opozitë, Kuvendi i Kosovës të martën ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme në të cilën është diskutuar lidhur me ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara nga ana e qeverisë. Deputetët e opozitës kanë thënë se qeveria ka filluar zbatimin e një praktike të keqe për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara. Sa i përket çështjes së shpenzimeve të paparashikuara, kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se kjo praktikë ekziston që nga koha e qeverive paraprake

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 MARS - Kuvendi i Kosovës, bazuar në kërkesën e 44 deputetëve nënshkrues, ka mbajtur të martën seancë të jashtëzakonshme lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara. Seanca është kryesuar nga nënkryetari Xhavit Haliti, (një pjesë u kryesua nga nënkryetari Kujtim Shala), ndërkaq në emër të iniciuesit të debatit ka folur deputeti Driton Selmanaj, i cili sqaroi se për shpenzimet e paparashikuara nuk kanë arritur të marrin ndonjë përgjigje nga qeveria, duke përmendur me këtë rast edhe mosraportimin e kryeministrit Ramush Haradinaj në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Në vijim të fjalës së tij, Selmanaj ka thënë se qeveria që nga marrja e mandatit ka filluar zbatimin e një praktike të keqe për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara. Ai ka shtuar se kjo po bëhet pa kritere vlerësuese dhe pa analiza të nevojave që t'i plotësojnë apetitet elektorale. Selmanaj ka shfaqur kritika të shumta për shënimin e 11-vjetorit të pavarësisë nga fondet rezervë, në shumën prej 500 mijë eurosh për realizimin e projekteve për këtë ngjarje, duke përmendur se para dy vjetësh për këtë ngjarje është ndarë shuma prej 70 mijë eurosh. Sipas tij, kjo qeveri ka ndarë shtatëfish më shumë buxhet për aktivitete të ngjashme, duke përmendur edhe përzgjedhjen e kompanisë, e cila, sipas tij, ka fryrë faturat.

Në fund të paraqitjes së tij, deputeti Selmanaj ka propozuar miratimin e një rezolute me këtë përmbajtje: 1. Qeveria e Republikës së Kosovës ta ndalë menjëherë praktikën e ndarjes së mjeteve financiare pa kritere dhe pa respektuar Ligjin për menaxhimin e financave publike. 2. Në afat prej një jave qeveria apo zyra e kryeministrit të sjellë në Kuvend një raport të detajuar për procedurat e zhvilluara për përzgjedhjen e kompanive që kanë realizuar aktivitetet dhe një raport me të dhëna specifike për shpenzimet e këtyre mjeteve dhe të fokusohet në tri ngjarjet kryesore, në shënimet e përvjetorëve të pavarësisë (vitit 2018 dhe 2019) si dhe në shënimin e 550-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut.

Deputetja e PDK-së, Safete Hadërgjonaj, fillimisht ka vlerësuar se ndarjet e rezervave shtetërore nuk e rrezikojnë shtetin, ndërkaq iu referua historikut shpenzimeve nga rezervat shtetërore. Ajo ka nënvizuar se nga viti 2013 deri në vitin 2017 praktika e shpenzimeve të mjeteve nga fondi rezervë ka qenë e ngjashme sikurse në kohën kur ishte ministër i Financave Avdullah Hoti dhe kryeministër Isa Mustafa. Ajo ka thënë se ngjarjet duhet të planifikohen përmes kodeve buxhetore dhe se PDK-ja do të angazhohet që çdo cent të shpenzohet me kujdes, me transparencë dhe llogaridhënie dhe të respektohet ligji për ndarjen e këtyre mjeteve për ngjarje të caktuara.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, duke dhënë një sërë kritikash drejtuar qeverisë, me theks të veçantë për ndarje të mjeteve financiare për shënimin e 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ka thënë se data e Pavarësisë së Kosovës nuk ndryshon dhe kjo qeveri në këtë mënyrë ka vepruar sikur mos ta dijë datën e pavarësisë. "Si është e mundur që këto shpenzime gjithmonë të jenë nga ky fond dhe me lëkundje të madhe financiare dhe askush nuk jep llogari?! Një emblemë e thjeshtë është paguar gati pesë euro, çmimi i së cilës sillet nga 0.50 cent deri në një euro. Tenderi i është dhënë ndonjë militanti dhe kjo është e gërditshme", ka thënë Konjufca.

Deputeti i AAK-së, Blerim Kuqi, duke kritikuar mbajtjen e këtij debati, ka thënë se nuk është shkelur as Ligji për buxhetin dhe as ai për menaxhimin e financave publike dhe kjo iu referohet neneve të caktuara. Sipas tij, Kuvendi është dashur të angazhojë për këtë çështje Auditorin e Përgjithshëm që të bëjë auditim për këtë çështje, e jo të thirrë seancë të jashtëzakonshme.

Ndërkaq deputetja e PSD-së, Shqipe Pantina, ka vlerësuar se mjetet për festa apo përvjetorë më mirë do të ishte të ndahen për kopshte fëmijësh apo për mbrojtjen e mjedisit, duke shtuar në vijim se të dhënat që u prezantuan për shpenzimet nga iniciuesi i debatit nuk janë fakte të mjaftueshme dhe se Kuvendi duhet fillimisht t'i kishte këto fakte, ose duke i ofruar vet qeveria në Kuvend dhe se miratimi i një rezolute të tillë është i pamjaftueshëm. Rezoluta, sipas saj, do të plotësohej mbi fillimin e procedurave të tjera hetimore.

Ndërsa deputeti i Nismës, Bilall Sherifi, u rezervua të flasë për këto çështje pasi, sipas tij, duhet të dëgjohet fillimisht versioni i qeverisë dhe mbi bazën e kësaj do të jepen qëndrime. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se ka kërkuar auditim të brendshëm për të parë të vërtetën lidhur me këtë çështje. "Sa i përket çështjes së shpenzimeve të paparashikuara, kjo praktikë ekziston që nga koha e qeverive paraprake", ka thënë kryeministri. Ai ka thënë se në vitin 2016 janë ndarë mbi 8 milionë euro, në vitin 2017 janë ndarë mbi 7 milionë euro. Haradinaj në vazhdim ka thënë se për shënimin e 11-vjetorit të pavarësisë janë shpenzuar vetëm 175 mijë euro dhe paratë e tjera të pashpenzuara do t'i kthehen buxhetit.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se ka të dhëna kronologjike të shpenzimeve, të bëra gjatë viteve, ndërkaq lidhur me debatin e sotëm ai ka vlerësuar: "Nëse e shikojmë në nivel të shpenzimeve atëherë nëpër vite ka qenë mesatarja rreth tetë milionë euro me ndonjë plus apo minus. Në vitin 2017 dhe në 2018-n, krahasuar me vitin 2016, ka rënie të shpenzimeve. Dhe, nëse hyjmë në strukturën e kësaj rezerve nëpër vite, ka pasur shpenzime nga rezerva", ka thënë Hamza, duke shtuar se për festimin e pavarësisë janë ndarë shumat me vendim të qeverisë dhe se presin të kenë raport zyrtar nga organizatat buxhetore dhe kur t'i kenë këto të dhëna, atëherë ato të bëhen transparente. Pas një diskutimi të gjerë të deputetëve, ku u vunë re dallime ndërmjet përfaqësuesve të pozitës dhe të atyre opozitarë, në mungesë kuorumi për vendimmarrje, rezoluta e propozuar nuk është hedhur në votim.

Asetet e sistemit financiar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.9 përqindësh

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka takuar të martën përfaqësuesit e Bankës Botërore të cilët po qëndrojnë në vizitë në Kosovë. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka deklaruar se sistemi financiar në Republikën e Kosovës ka pasur zhvillime pozitive, ku asetet e sistemit financiar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.9 përqindësh, ndërsa kreditimi bankar ka shënuar rritje vjetore prej 11 përqindësh, normat e interesit në kredi kanë zbritur në 6.3 për qind, ndërsa norma e kredive joperformuese ka shënuar rënie në 2.7 për qind. Guvernatori Mehmeti i njoftoi përfaqësuesit e BB-së lidhur me zhvillimet pozitive në sektorë të tjerë, si sektori i sigurimeve, i pensioneve dhe ai i institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jobankare.

Ujësjellësi alarmon për rënie të nivelit të ujit në liqenet akumuluese

Prishtinë, 12 mars (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka bërë me dije se niveli i ujit në liqenet akumuluese ka pësuar rënie. Niveli i ujit në liqenin e Batllavës është 4 metra nën kuotën maksimale, ndërsa niveli i ujit në liqenin e Badocit 4.2 metra nën kuotën maksimale. Sipas ujësjellësit, krahasuar me vitin e kaluar në të njëjtën periudhë 12 mars 2018, të dy liqenet ishin në nivelin kapërderdhës, pra mbi kuotën maksimale. "Pothuajse nga gjysma e vitit të kaluar e deri më tash kemi mungesë të reshjeve atmosferike dhe po të mos ishte marrja e ujit nga liqeni i Ujmanit, nivelet e tanishme do të ishin dukshëm më të ulëta. Pavarësisht prej gjendjes së tanishme/rënies së nivelit të ujit në liqene, ne kemi edhe plane konkrete për menaxhimin e thatësirës dhe në varshmëri të niveleve parashikohen edhe hapat që duhet të merren për menaxhimin e situatave në akumulacione dhe burime nëntokësore në vitet me thatësira që vijnë si rezultat i ndryshimeve klimatike në tokë", ka njoftuar KRU "Prishtina".

Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" u ka bërë thirrje të gjithë konsumatorëve ta kursejnë ujin.

BREZh-i dhe Banka Evropiane Investive mbështesin realizimin e projektit për trajtimin e ujërave të zeza në Mitrovicë

Mitrovicë, 12 mars (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur në takim përfaqësuesit e BREZh-it dhe Bankës Evropiane Investive, Lijana Jancauskiene, Konstatinos Mastroglanopulos, Andre Oosterman dhe Bekim Muharremin, me të cilët kanë biseduar për procedurat e mëtutjeshme lidhur me projektin e trajtimit të ujërave të zeza.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Egzon Jashari, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, drejtori i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit, Sami Miftari, dhe koordinatori i projektit në këtë kompani, Xhevat Smajli.

Qëllimi i këtij takimi ishte që të mblidhen të dhëna e duhura për realizimin e këtij projekti si dhe të njihen më për së afërmi me detajet e tjera për kryerjen e procedurave.

Ky projekt kapital është i ndarë në dy faza, në fazën e parë është e përfshirë Mitrovica e Jugut, ndërsa në fazën e dytë do të hyjë Mitrovica e Veriut dhe Zveçani, i cili financohet nga BERZh-i dhe Banka Evropiane Investive nëpërmes Qeverisë së Kosovës.

Me këtë rast nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, u shpreh falënderues për përfaqësuesit e të dyja bankave lidhur me gatishmërinë dhe interesimin e tyre që ta mbështesin realizimin e projektit për trajtimin e ujërave të zeza, duke e vlerësuar si projekt shumë i rëndësishëm për qytetarët e Mitrovicës.

Ndërsa drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Egzon Jashari, ka njoftuar të pranishmit lidhur me procedurat ligjore që komuna është e përkushtuar t'i kryejë për realizimin e këtij projekti. Ai ka bërë me dije se komuna në vazhdimësi është në kontakt me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për t'i përfunduar sa më shpejt procedurat në mënyrë që ky projekt të fillojë sa më shpejt.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Prizren do të ofrojë shërbime mjekësore 24 orë

Prizren, 12 mars (ER) - Tani e tutje Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren do të punojë edhe me ndërrimin e tretë dhe do t'u ofrojë qytetarëve të Komunës së Prizrenit shërbime mjekësore për 24 orë. Krahas njësisë së Urgjencës, QKMF-ja do të jetë adresa e dytë shëndetësore e nivelit komunal që do të punojë me orar të plotë. Me këtë rast, Njësia e Urgjencës do të lirohet nga mbingarkesa dhe do të merret vetëm me rastet urgjente, derisa në QKMF do të ofrohen shërbime për raste që nuk janë urgjente.

Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, dhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Visar Shehu, së bashku me stafin menaxhues të QKMF-së, përuruan këtë shërbim të ri. "Me anë të shërbimeve cilësore, pastërtisë dhe mënyrës së trajtimit të pacientëve, po kthehet besimi i qytetarëve ndaj institucioneve shëndetësore në nivelin komunal. Rreth 80 % të shërbimeve mjekësore po kryhen në shërbimin parësor mjekësor, duke filluar që nga analizat e deri te mamografia dhe kjo e bën Komunën e Prizrenit njërën prej komunave më të suksesshme në këtë aspekt", ka thënë kryetari Haskuka.

Ndërsa drejtori Shehu me këtë rast ka bërë me dije se shërbimi 24 orësh në QKMF është pjesë e reformës që po bëhet në shërbimin parësor shëndetësor dhe paralajmëroi edhe për shumë projekte të reja që do të realizohen gjatë këtij viti.

Sot fillojnë ligjëratat për vetëdijesimin e njerëzve kundër etheve hemorragjike

Malishevë, 12 mars (ER) - Në kuadër të zbatimit të masave parandaluese kundër Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHKK), nga sot (e mërkurë) do të nisë mbajtja e ligjëratave vetëdijesuese për rrezikun nga thumbimi i rriqrave të cilat e bartin virusin EHKK. Ligjëratat do të mbahen në shkollat e fshatrave Llazicë dhe Balincë, ndërsa këto ligjërata do t'i mbajnë profesionistët e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë.

Mbajtja e ligjëratave për vetëdijesimin e njerëzve është pjesë e masave parandaluese të EHKK-së dhe organizohen në bashkëpunim me Këshillim Komunal për Menaxhimin e EHKK-së në Malishevë.

NJË LIBËR I RËNDËSISHËM PËR DËSHMORIN ILIR DURMISHI

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Më 11 mars, në përvjetorin e 38-vjetorit të demonstratave studentore dhe të 20-vjetorit të rënies së dëshmorëve Ilir Durmishi, Hyzri Talla dhe Afrim Maliqi, jam e nderuar dhe kam kënaqësinë e veçantë të referoj dhe njëherësh të promovojmë së bashku me ju monografinë e prof. Hamdi Thaqit - "Ilir Durmishi, dëshmor i kombit".

Amos Ozinin, shkrimtarin izraelit, i cili ishte kandidat për çmimin Nobel më 2008, e kishin pyetur gazetarët: "Po mos të ishe njeri, çfarë kishe dashur të ishe? Ai, pa hezituar, ishte përgjigjur: "Sigurisht se kisha dashur të isha libër ngaqë çdo gjë humb e tretet, por libri, diku, në ndonjë qoshe të ndonjë biblioteke apo familjeje, ngel dhe nuk zhduket kurrë...".

E fillova recensionin me këto fjalë të Amos Ozit ngaqë që në fillim duhet thënë se, prof. Hamdi Thaqi ka bërë një gjë të mirë, kur atdhetarin Ilir Durmishin nuk e la që ta mbulojë pluhuri i harresës, por hulumtoi, grumbulloi dhe sistemoi, gati të gjithë veprimtarinë e atdhetarit dhe sot na vjen me veprën e radhës "Ilir Durmishi, dëshmor i kombit".

Është interesant se në qenien e njeriut është diçka që e determinon fatin dhe kahet e jetës. Është diçka që vë në lëvizje njeriun dhe vetëdijen e tij. Janë këto ide apo ideale që mund të formulohen me fjalët "Spiritus muvensi", apo shpirt që lëviz. Dhe, duhet shtuar se, jeta dhe vepra e atdhetarit Ilir Durmishi ishte trinom i ecjes nëpër misteret e kohës, nëpër sfidat e paparashikuara të jetës dhe nëpër damarët e historisë kombëtare dhe, njëmend, e bëjnë këtë të ri "Shpirt lëvizës", prej atdhetari të devotshëm.

Vitet e luftës dhe padrejtësitë e shumta që iu bënë Kosovës, pas vitit 1945, edhe një herë nxorën në shesh reagimet dhe pakënaqësitë e popullit të saj. Në këto kushte të krijuara forcat nacionaliste në Kosovë vazhdimisht u ndodhën të zhgënjyera e të tradhtuara, përballë vështirësive, por edhe obligimeve të reja që morën, për të ndryshuar situatën që mbretëronte.

Mu, në këtë luftë dhe, në këtë veprimtari patriotike ilegale, shquheshin pa dyshim, trinomi atdhetar Ilir Durmishi, Hyzri Talla dhe Afrim Maliqi, që deri në fund të jetës nuk reshtën së luftuari, e së punuari për çështjen kombëtare. Të cilët, gjatë veprimtarisë së vet, kombinuan me sukses, veprimtarinë legale me atë ilegale, atë paqësore me atë luftarake, dhe, në këtë mënyrë, artikulonin me vendosmëri dhe besnikëri, luftën dhe kërkesat kundër robërisë dhe ripushtimit jugosllav.

Ata, ishin të vetëdijshëm se periudha në të cilën po kalonte Kosova, ishte e mbarsur me plot rreziqe. Andaj nuk u pajtuan kurrë me këtë fund okupues dhe lufta e tyre ishte e vazhdueshme. Prof. Hamdi Thaqi librin e titullon: "Ilir Durmishi, dëshmor i kombit" por në tekst me një mjeshtri të rrallë shkrimore, autori Thaqi flet dendur për Hyzri Tallën e Afrim Maliqin. Dhe, mendoj se libri vetëm në këtë formë i shkruar është i kompletuar, ngase, vetëm të bashkuar tre dëshmoret, do të jen vetvetja; do të jenë ata që janë. Trinomi i atdhetarisë, Ilir Durmishi, Hyzri Talla e Afrim Maliqi janë të plotësuar; janë jeta e fronti i përbashkët i luftës; janë liria e gjakuar me shekuj për Kosovën e robëruar; se vetëm si të tillë, janë heronjtë e saj.

Rrallë ndodhë të përsëritet historia, por tek ne, historia u përsërit edhe atë në mënyrën më të vrazhdë. Jo se e deshëm ne, por këtë, na imponuan gllabëruesit e shumtë që i rrethonin trojet tona. Vargu i gjatë i vrasjeve pothuajse i bartësve kryesor të idealit dhe fatit të determinuar historik, u kryen në terrin e zi të bardhësisë së ngrirë të dhjetorit. Ata, Iliri, Hyzriu e Afrimi në mënyrën më sublime do të përcjellin mesazhet e qëndresës epokale të popullit të Kosovës, ndaj dhunës e terrorit të Serbisë në vitet e '80-ta e të '90-ta

Ata, kishin vizion të qartë për të ardhmen e Kosovës, dhe, guximin e duhur, për të vepruar kundër regjimit të atëhershëm okupues. Iliri, Hyzriu e Afrimi vlerësohen si tri figurat e rëndësishme të rezistencës dhe përpjekjeve të popullit shqiptarë të Kosovës për liri e pavarësi, dhe janë çmuar për trimërinë, sakrificën e lartë dhe aftësitë organizative. Trinomi, Durmishi, Maliqi dhe Talla, në jetën e tyre të shkurtër, kishin shumë gjëra të përbashkëta. Të tre vinin nga familje atdhetarësh, që gjatë tërë jetës, kishin luftua për lirin e vendit, duke mos kursyer as gjakun e jetën e tyre. Sipas shumë të dhënave thuhej se, shumë familjar të tyre pas vitit 1945, kur Kosova pa dashjen e saj kishte ngelur nën okupimin serb e jugosllav, ata ishin të angazhuar në organizata e grupe ilegale shqiptare që luftonin për lirinë e Kosovës.

Udbashët, duke i ditur biografit e tyre, filluan, qysh në ditët e para të shkollimit, ti survejonin. Ata, nuk ishin të kënaqur me atë që panë, andaj filluan që të shohin një rrezik permanent nga ata. Ky ishte edhe shkaku që nga viti 1981, e deri më 2 dhjetor 1998 trinomi atdhetar ishte aktiv në veprimtarin ilegale ushtarake të Kosovës. Që nga ky vit, marrin pjesë aktive në demonstratat studentore. Po ashtu ishin aktiv në shkrimin dhe shpërndarjen e parullave e trakteve, me përmbajtje anti-jugosllave.

Që nga ditët e para të veprimtarisë ilegale, që i zhvilluan, e, deri më 2 dhjetor 1998, ata, për asnjë moment nuk ditën të ndalen. Ata, ecën edhe atëherë kur nuk mund të ecej dot, dhe me gjakun e tyre ujitën tokën e robëruar të Kosovës, për ditët e mira që i gëzojmë ne sot. Ilir Durmishi, Hyzri Talla e Afrim Maliqi, sintetizojnë dy dimensione të rëndësishme në harkun e tyre jetësor: 1. të besnikërisë dhe të vetësakrificës për shokët e idealit, si dhe nën 2. atë historik, të çlirimit dhe bashkimit kombëtar.

Ndikimi i këtij trinomi të përbërë nga tre personalitete të përmasave të mëdha kombëtare, në rrjedhat historike shqiptare është i pakontestueshëm, i dukshëm, pozitiv, i përbashkët, por, edhe i veçantë. Shumica prej këtyre komponentëve, qe e stolisin personalitetin e njërit dhe tjetrit, si vëlla të këtij trinomi, nga studiuesit e vëmendshëm, mund të vërehen në tërësinë e jetës dhe të veprimtarisë së tyre të bujshme, të pandalshme, të rëndë, por, të suksesshme, dhe të kurorëzuar, më realizimin e shumicës së ideve dhe të planeve të tyre politike, ideore dhe kombëtare.

Dëshmori Ilir Durmishi, Hyzri Talla dhe Afrim Maliqi, u kthyen në sinonim të vullnetit dhe të dashurisë sonë individuale dhe kolektive, për t'u bashkuar me rrjedhat e rezistencës, dhe për t'u mobilizuar në fusha të ndryshme të rezistencës. Jeta dhe vepra e trinomit atdhetar dhe, e patriotëve të tjerë, të rënë në altarin e lirisë, fryma, roli, aksioma e jetëve të tyre, ishte një dhe e pandarë: kryekëput në shërbim të kauzës së lirisë.

Veçse, kjo kauzë e Bregut të Diellit, e parë nga dimensioni universal i kauzës së lirisë, ishte në bërthamën e saj edhe si një kauzë me mesazh ndërkombëtar. Se çfarë ishte roli dhe ndikimi i ngjarjes së Bregut



të Diellit më 2 dhjetor 1998, e tregon fakti se pas kësaj ngjarje, rezistenca aktive në Kosovë, hyri jo vetëm në momentet e pakthyeshme të saj, porse, depërtoi edhe në agjendën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ndërhyrja politike dhe ushtarake në Kosovë, përgjatë vitit 1999, tregon më së miri se si ngjarja e 2 dhjetorit, e e shumë dhjetorëve e janarëve të tjerë, pati ndikim të drejtpërdrejtë në arenën ndërkombëtare.

Nëpërmjet librit, të prof. Hamdi Thaqit, do të njihemi më mirë me sakrificën, mundin e vuajtjet e tyre dhe të brezave të tërë. Duke njohur çmimin e lirisë, brezat do ta duan dhe çmojnë më shumë atë, do ta ruajnë e mbrojnë më mirë, do ta përparojnë e forcojnë me shembullin e atyre që e sollën. Autori, prof. Hamdi Thaqi, nëpërmjet këtij botimi, ua bën të mundur gjeneratave të sotme, njoftimin me aktivitetin, veprimtarin dhe guximin e atdhetarëve të devotshëm të ndjehemi krenar për ata.

Jam e bindur se, me anën e këtij libri, autori Thaqi, ka arritur që në mënyrën më sublime, të freskojë dhe të ringjallë kujtesën kolektive, për historinë tragjike e, të dhembshme, që kanë kaluar atdhetaret tanë dhe shumë e shumë gjenerata të Kosovës martire. Kjo rilindje dhe ky libër janë shumë të nevojshme edhe për një arsye që të mos na përsëritet historia, sepse, po qe se harrohet ajo, jemi të detyruar ta përsërisim, thotë filozofi Santajana.

Monografia "Ilir Durmishi, dëshmor i kombit", nga autori e studiuesi i jetës dhe veprës së atdhetarit, prof. Hamdi Thaqi, ka një strukturë përmbajtjesore që nuk e gjejmë tek biografitë e tjera të atdhetarëve. Përndryshe është një sihariq që na ofron të dhëna të bollshme biografike e historiografike, që gjer më tani kanë qenë të panjohura për opinionin e gjerë. Botimi i kësaj vepre do të jetë më se i mirëseardhur ngaqë jeta e vepra e Ilir Durmishit dhe shokëve të tij është e lidhur ngushtë me ndriçimin e historisë më të re të lëvizjes kombëtare shqiptare në Kosovë e më gjerë.

Dhe, krejt në fund, uroj autorin prof. Hamdi Thaqin për librin e punuar me shumë përkushtim dhe njëherë presim që nga penda e tij e vyeshme të na dhurojë edhe shumë vepra të tjera me vlera shkencore.

(Fjalë e mbajtur në promovimin e librit "Ilir Durmishi, dëshmor i kombit", Prishtinë, 11 mars, 2019)

E rrallë

Nëna harron fëmijën në aeroport, avioni kthehet mbrapsht në mes të fluturimit

Një avion është kthyer mbrapsht në aeroport pasi një nënë ka pohuar se kishte harrur fëmijën e saj në terminal. Saudi Airlines ishte nisur në fluturim nga Jeddah, Arabinë Saudite, për në Kuala Lumpur, Malajzi. Por nëna u kujtua në avion se kishte lënë fëmijën në terminal dhe u kërkoi pilotëve të ktheheshin për ta marrë. Piloti u kërkoi kontrollorëve të trafikut ajror leje për t'u kthyer në aeroport. Rrethanat në të cilat nëna harroi fëmijën në aeroport janë të paqarta. Dhe kjo çoi në vonesën e fluturimit 45 minuta.

FOTO E DITES

12 mars, bora në Komunën e Deçanit

E jashtëzakonshme

Zvicra ka rezervat më të mëdha të valutave dhe të arit në Evropë

Rezervat më të mëdha të arit dhe valutave të huaja në Evropë janë në Zvicër, sipas të dhënave nga burimi i referencës "World Factbook", i cili vepron në Agjencinë Qendrore të Inteligjencës të ShBA-së. Sipas kësaj harte, rezervat e arit dhe të këmbimit valutor në Zvicër arrijnë në 679.3 miliardë dollarë. Në vendin e dytë është Rusia me ar dhe rezerva valutore në shumën prej 418.5 miliardë dollarësh dhe në të tretën është Gjermania me rezerva valutore dhe ari me vlerë 185.3 miliardë dollarë.

BARSOLETA E DITËS

Profesori: A po bisedoj me babën e Gentit?
Prindi: Po, i nderuar.
Profesori: Djali juaj e ka thyer një bankë.
Prindi: S'ma merr mendja bre, se centin në shtëpi s'e ka pru.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI Sot do të shkojë gjithçka siç e keni parashikuar. Jeni nën një aureolë optimizmi që do të bëjë që gjithçka të shkojë vaj.

DEMI Sot jeni ju protagonistët e ditës në sajë të një marrëveshjeje mjaft të favorshme që keni arritur të mbyllni. Do të filloni të merrni përfitime shumë shpejt.

BINJAKËT Do t'ju duhet të jepni prova që mund të përballoni një situatë stresi pa u alarmuar dhe pa ju zënë paniku. Më përpara nuk keni mundur ta superoni këtë gjë.



GAFORRJA Çdo gjë që ka lidhje me ju sot do të jetë e ekzagjeruar. Do të doni shumë, do të luftoni shumë, do të mërziteni shumë dhe në çdo rast nuk do të ndaloni.

LUANI Sot do të jeni kapriçioz për çdo gjë si në familje. Do të kundërshtoni këdo edhe në punë që nuk do t'ju pëlqejë asgjë që do t'ju propozohet.

VIRGJËRESHA Edhe pse keni dyshime në një bisedë të bërë kohët e fundit, nuk do t'i shprehni ato pa u siguruar nëse qëndrojnë apo jo.



PESHORJA Është periudha më e mirë për të folur për pushime dhe për udhëtime. Doni të vizitoni kultura të ndryshme dhe të panjohura.

AKREPI Xhelozi dhe debate në çdo çast me partnerin, tregojnë se duhet të vendosni një kufi ose duhet të lini gjithçka.



SHIGJETARI Një ditë shumë e mirë sot për të gjithë ju që keni punuar fort për t'i arritur qëllimet tuaja. Më në fund, pak dritë në fund të tunelit.

BRICJAPI Disi në mënyrë të ndrojtur, por më shumë dashuri, do të arrini t'i shprehni ndjenjat njeriut të zemrës. Kjo gjë do t'ju afrojë më shumë bashkë.

UJORI Një ditë shumë e zakonshme dhe pa asnjë kulm të rëndësishëm. Gjithsesi ju dini të argëtoheni në çdo çast.

PESHQIT Hëna në shenjë ju favorizon në çdo aspekt të jetës, por më shumë në atë sentimental. Jeni gjithë kohës në krahët e partnerit.



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	BAYERN - LIVERPOOL	X-1	BARCELONA - LYON	1-1	WBA - SWANSEA	1

Fetahaj: Celina, çelësi i mbijetesës për Lirinë

Liridon Fetahaj ka thënë për "Epokën e re" se Liria do ta sigurojë mbijetesën në elitën e futbollit të Kosovës për faktin se tash në krye të saj është një trajner i dëshmuar siç është Erdogan Celina. "Liria ka kualitet për ta siguruar mbijetesën qoftë edhe nëpërmjet barazhit, kurse Celina do të jetë çelësi ynë për ta arritur këtë synim", ka thënë Fetahaj

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 MARS - KF Liria, pas rezultateve të dobëta javë më parë, e largoi trajnerin italian Vincenzo Alberto Annese, kurse atë e zëvendësoi me trajnerin e dëshmuar në futbollin e Kosovës, Erdogan Cilina. Kjo lëvizje e drejtuesve të klubit doli të jetë e qëlluar, pasi Celina në dy ndeshjet me Lirinë ka arritur katër pikë. Lojtari kryesor dhe kapiteni i skuadrës nga Prizreni, Liridon Fetahaj, ka shprehur mendimin se pikërisht trajneri në fjalë do të jetë çelësi i mbijetesës në IPKO Superligë. "Ardhja e trajnerit Celina ka sjellë një frymë dhe energji të re në klub. Me të kam punuar edhe më herët dhe mund të them se ka një përvojë të madhe dhe të gjithë lojtarët e respektojmë shumë, kurse personalisht kam mësuar shumë nga trajneri Celina. Paraqitjet pozitive në dy ndeshjet e fundit kanë qenë si pasojë e asaj se lojtarët u janë përgjigjur në përpikëri kërkesave të trajnerit. Liria ka kualitet për ta siguruar mbijetesën qoftë edhe nëpërmjet barazhit, kurse Celina do të jetë çelësi ynë për të arritur këtë synim", ka thënë Fetahaj për "Epokën e re". Ndeshjen e parë Liria me trajnerin Erdogan Cilina e fitoi si mysafire ndaj Trepçës '89, me rezultat 1-2, kurse në ndeshjen e dytë si vendëse barazoi me Drenicën (1-1). Ndeshjen e radhës Liria e zhvillon ndaj Dritës së Gjilanit, ndërsa lidhur me këtë ndeshje futbollisti Fetahaj është i bindur se prizrenasit do të rikthehen nga Gjilani me rezultat pozitiv. "Para vetes e kemi edhe një tjetër ndeshje të vështirë ndaj kampiones aktuale të elitës, Dritës. E respektojmë këtë skuadër në maksimum, por shkojmë për rezultat pozitiv dhe besoj se mund t'ia arrijmë qëllimit", ka shtuar Fetahaj. Aktualisht skuadra e Lirisë, që është ndër klubet me traditë në futbollin e Kosovës, renditet në pozitën e dhjetë me 24 pikë, katër pikë më pak se skuadra e Ballkanit që pozicionohet e nënta.

MKRS-ja u jep mbi 750 mijë euro tri federatave

"Me këtë përkrahje ministria po krijon mundësi dhe po ua lehtëson federatave realizimin e planeve dhe të objektivave të tyre. Me këto memorandume federatat do të funksionojnë me më efikasitet dhe do ta kenë pavarësinë e plotë për ta avancuar sportin në Kosovë", ka thënë ministri Kujtim Gashi

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në kuadër të mbështetjes financiare për federatat e sportit, ka nënshkruar të martën memorandume bashkëpunimi me tri federata të sporteve kolektive: Federatën e Futbollit, Hendbollit dhe Volejbollit, kurse shuma totale e mbështetjes financiare arrin në vlerën e mbi 750 mijë eurove.

Memorandumi i nënshkruar me Federatën e Futbollit të Kosovës është në vlerën prej 276 590 euro, me Federatën e Hendbollit vlera është 245 752 euro dhe 243 678 euro me Federatën e Volejbollit të Kosovës. Në bazë të memorandumeve, federatat janë të obliguara që këto mjete t'i shfrytëzojnë për realizimin e politikave të tyre programore.

Ministri Kujtim Gashi ka thënë se këto memorandume nënshkruhen në kuadër të realizimit të përkrahjes së drejtpërdrejtë të federatave, aq më tepër kur bëhet fjalë për sportet kolektive, ku masiviteti në sport është një ndër prioritetet e ministrisë. "Me këtë përkrahje ministria po krijon mundësi dhe po ua lehtëson federatave realizimin e planeve dhe të objektivave. Me këto memorandume federatat do të funksionojnë me më efikasitet, do ta kenë pavarësinë e plotë për ta avancuar sportin në Kosovë", ka thënë ministri Gashi.

Ndërsa drejtuesit e federatave e falënderuan ministrin për përkrahjen që po i ofron sportit në përgjithësi. Ata u shprehën se me mbështetjen që MKRS-ja ka dhënë për federatat përkatëse do të ndihmohet sporti dhe sportistët, duke premtuar se do të fokusohen për masivizimin dhe cilësinë në sport.

Risi në listën e Challandesit për ndeshjet ndaj Danimarkës dhe Bullgarisë

PRISHTINË, 12 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do t'i zhvillojë këtë muaj dy ndeshje. Fillimisht "Dardanët" do të luajnë në ndeshjen miqësore ndaj Danimarkës, kurse më pas, në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2020", do të takohen me Bullgarinë. Për këto dy ndeshje trajneri Bernard Challandes do të ftojë 24 futbollistë, kurse risi është ftesa për sulmuesin Florent Hasani.

Lista e futbollistëve: Samir Ujkani, Arijanet Muriq, Visar Bekaj, Amir Rrahmani, Fidan Aliti, Mërgim Vojvoda, Leart Paqarada, Benjamin Kololli, Arbenit Xhemajli, Mirlind Kryeziu, Florent Hasani, Bersant Celina, Valon Berisha, Hekuran Kryeziu, Herolind Shala, Idriz Voca, Besar Halimi, Arbër Zeneli, Milot Rashica, Edon Zhegrova, Bernard Berisha, Vedat Muriqi, Atdhe Nuhiu, Lirim Kastrati.

KOK-u dërgon trajnerët në kampe jashtë vendit

PRISHTINË, 12 MARS - Komiteti Olimpik i Kosovës do të nisë një fazë të re të përkrahjes së federatave sportive në Kosovë. Bordi Ekzekutiv i KOK-ut ka vendosur që t'i dërgojë trajnerët e federatave në kampe apo shkollime që organizohen jashtë vendit. Qëllimi i kësaj përkrahje është shkollimi i trajnerëve dhe marrja e përvojave të reja, të cilat do të mund t'i zbatonin te sportistët e federatave të tyre. Në mbledhjen e radhës të BE të KOK-ut do të vendosen edhe kriteret të cilat duhet t'i plotësojnë federatat për dërgimin e trajnerëve. Kjo është vetëm një nga format e mbështetjes së KOK-ut për federatat, pas përkrahjes që bënë çdo muaj për bursistët olimpikë, shpresat olimpike, përgatitjet e sportistëve para garave të rëndësishme ndërkombëtare, ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si: kurset për administratorë sporti, kurset për trajnerë, si dhe kursi i avancuar për menaxhimin sportiv (ASMC 1).

Sonte kompletohen çerekfinalistët në Ligën Kampionëve

MUNCHEN, 12 MARS - Sonte (e mërkurë) kompletohen skuadrat çerekfinaliste në Ligën e Kampionëve, pasi zhvillohen dy ndeshjet e fundit të 1/8 së finales në mes të Bayern Munchenit dhe Liverpoolit dhe Barcelonës dhe Lyonit. Ndeshja kryesore zhvillohet në Gjermani, kurse trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka kërkuar që futbollistët e tij të bëjnë një paraqitje superiore nëse dëshirojnë ta eliminojnë Bayernin. "Bayerni është në një fazë më të mirë se ne. Bavarezët janë udhëheqësit e rinj të Bundesligës. Ata janë kthyer në nivelin më të lartë të këtij sezoni, prandaj duhet të jemi të jashtëzakonshëm të mërkurën në 'Allianz Arena'. Nëse luajmë një ndeshje normale nuk do të kemi mundësi kualifikimi për më tej", ka thënë Klopp.

Për këtë ndeshje foli edhe ylli i Bayernit, Franck Ribery. Francezi ka lënë të nënkuptohet se ekipi gjerman nuk ka frikë nga Liverpooli dhe nëse luajnë të bashkuar, kualifikimi në çerekfinale do të ndodhë. "Atmosfera është pozitive edhe për faktin se do të luajmë në shtëpi. Liverpooli ka një ekip të fortë, por ne jemi Bayern Munchen. Kemi besim në aftësitë tona dhe nuk kemi frikë nga Liverpooli. Nëse luajmë së bashku dhe luftojmë, atëherë mund të shkojmë në çerekfinale. Kemi një shans të vërtetë për këtë", ka deklaruar Ribery.

Ndeshja e parë në mes këtyre dy skuadrave, e zhvilluar në Angli, kishte përfunduar 0-0. Bayern Munchen do të jetë në këtë ndeshje pa Joshua Kimmich dhe Thomas Mullerin të cilët nuk kanë të drejtë loje, kurse Corentin Tolisso dhe Kingsley Coman janë të lënduar, derisa David Alaba dhe Arjen Robben janë në dyshim. Lajm i mirë për Liverpoolin është rikthimi i Virgil van Dijkut, kurse mungesat e vetme janë Joe Gomez dhe Alex Oxlade-Chamberlain. Në ndeshjen tjetër do të përballen në "Camp Nou", Barcelona dhe Lyoni. Edhe ndeshja e parë në mes të këtyre dy skuadrave kishte përfunduar me rezultat 0-0.

TË MËRKURËN TAKOHEN:

21:00 Bayern Munchen - Liverpool	(0-0)
21:00 Barcelona - Lyon	(0-0)

Houstoni 9 fitore radhazi, clippersat i japin 'leksion' Bostonit

HOUSTON, 12 MARS - Skuadra e Houstonit vijon serinë pozitive në NBA, duke mundur 118-106 Charlotten, suksesi i nëntë radhazi në kampionat. Një ndeshje e dominuar nga skuadra teksane, që ngjitet në vendin e tretë në renditje në Perëndim. Hardeni realizoi 28 pikë e 10 asistime, mbështetur edhe nga Gordoni me 22 pikë, ndërsa 40 pikët e Walkerit për miqtë mbetën për statistikë. Fitojnë edhe clippersat, që mundën 140-115 Bostonin, ndeshje ku kalifornianët patën epërsi gjatë gjithë kohës dhe e merituan fitoren. Shtatë lojtarë të Clippersit realizuan mbi 10 pikë, me Lou Williamsin që realizoi 34 pikë. Oklahoma, falë 24 pikëve të Schroderit dhe 23 të Westbrookut, mundi 98-89 Utah Jazzin, sfidë ku ekipi i Thunderit u shkëput gradualisht nga perioda në periodë. Surprizë fitorja 126-101 e Clevelandit ndaj Torontos, sfidë ku Cavaliersi bën

një paraqitje të mirë, raporton "Telesport". Sextoni me 28 pikë ishte shënuesi më i mirë për vendësit, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e Leonardos për kanadezët. Washingtoni mundi 121-115 Sacramenton, takim ku diferencën në parket e bëri Beali, autor i 27 pikëve, ndërsa Brooklyni mundi 103-75 Detroitin, sfidë ku Dinwiddie realizoi 19 pikë, më i miri në fushë.

REZULTATET

Cleveland - Toronto	126-101
Washington - Sacramento	121-115
Brooklyn - Detroit	103-75
Houston - Charlotte	118-106
Utah Jazz - Oklahoma	89-98
Clippers - Boston	140-115

SHKURT

Zidane nuk lejon shitjen e Marcelos

Trajneri Zinedine Zidane i ka kërkuar presidentit të Real Madridit, Florentino Perezit, të mos e lejojë shitjen e mbrojtësit brazilian, Marcelo. Sipas së përditshmes braziliane "A Bola Brasil", Zidane dëshiron ta mbajë Marcelon në "Santiago Bernabeu", pasi beson se ai do të jetë i rëndësishëm për projektin e tij në klub. Gjatë javës së kaluar mediet italiane raportuan se Marcelo ka arritur marrëveshje me Juventusin dhe se transferimi i tij do të ndodhë gjatë verës.

Sanchezi do të largohet nga Unitedi

Sulmuesi Alexis Sanchez pritet të largohet në fund të këtij edicioni nga skuadra e Manchester Unitedit, njoftojnë të martën mediumet angleze. Sulmuesi kilian nuk bën pjesë në planet e trajnerit Ole Gunnar Solskjaer, i cili pritet së shpejti të firmosë kontratë afatgjatë me ekipin anglez. Solskjaer nuk është i kënaqur aspak me Sanhezin, i cili këtë edicion është përballur me lëndime të shumta. Ai ka kërkuar shitjen apo huazimin e Sanchezit në një ekip tjetër. Sanchezi 30-vjeçar, këtë edicion ka shënuar dy gola në 23 paraqitje në të gjitha garat. Sanchez te Manchesteri u transferua në janar të vitit të shkuar nga Arsenali dhe me "djajtë e kuq" ka kontratë deri në vitin 2022. Ai karrierë ne Evropë ka bërë edhe te Barcelona e Udinese.

Baptista mbyll aventurën në Rumani

Julio Baptista i habiti të gjithë me zgjedhjen e tij një vit më parë teksa firmosi për CFR Cluj, një ndër ekipet më të mirë të Rumanisë. Braziliani, tashmë në moshë 37-vjeçare, nuk është se e shijoi shumë aventurën e tij, pasi aktivizimet ishin të pakta. Klubi i CFR Cluj ka njoftuar se ka zgjidhur kontratën me sulmuesin, i cili do të jetë lojtar i lirë tashmë. Kujtojmë, në karrierën e tij Baptista ka veshur fanellën e Realit të Madridit, Arsenalit, Sevilles dhe të Romës.

Perezi preferon Mbappen para Neymarit

